



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:204326

Datë: 20.11.2024

Numri i dokumentit: 06481156

PPP.nr.21/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik, si gjykatë përmbarimore e shkallës së parë, gjyqtari Burhan Berisha-gjyqtar përmbarues, me bashkëpunëtorin profesional Ismail Kuçi duke vendosur në çështjen përmbarimore të kreditorit OJQ IMF ... , rr. "...” nr. 38 , të cilin e përfaqëson A. S. me seli në Prishtinë, kundër debitorit 1.V. A. me vendbanim në rr. "...” Komuna Hani i Elezit, 2. F. A. me vendbanim në rr. "N. B.” Komuna Hani i Elezit dhe 3.F. Z., rr. "...” Komuna Ferizaj, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, në seancë jashtëgjyqësore më datë 20.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET, prapësimi i 1.V. A. me vendbanim në rr. "...” Komuna Hani i Elezit, 2.F. A. me vendbanim në rr. "...” Komuna Hani i Elezit dhe 3.F. Z., rr. "...” Komuna Ferizaj, i ushtruar më datë 24.03.2021, kundër Urdhërit mbi lejimin e përmbarimit të përmbaruesit privat P.nr.124/2021 të datës 12.03.2021, në tërsi SI I PABAZUAR.

II DETYROHET, debitori që ta bëjë pagesën e borxhit sipas propozimit për përmbarim, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, të gjitha këto pagesa do të bëhen në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Kreditori OJQ IMF ... , rr. "... " nr. 38 , të cilin e përfaqëson A. S. me seli në Prishtinë, më datë 12.03.2024, ka paraqitur propozim për përmbaram ndaj debitorit I.V. A. me vendbanim në rr. "... " Komuna Hani i Elezit, 2.F. A. me vendbanim në rr. "... " Komuna Hani i Elezit dhe 3.F. Z., rr. "Kongresi i Manastirit" Komuna Ferizaj, në zyrën e përmbaruesit privat B. H. A. Rr."..." p.n, Ferizaj.

Me këtë propozim ka kërkuar nga përmbaruesi që të lejohet përmbarami dhe të obligohet debitori që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 1,725.29€, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbaramore.

Përmbaruesi Privat më datë 12.03.2021, ka lejuar përmbaramin ndaj debitorit I.V. A. me vendbanim në rr. "... " Komuna Hani i Elezit, 2.F. A. me vendbanim në rr. "... " Komuna Hani i Elezit dhe 3.F. Z., rr. "... " Komuna Ferizaj, ndërsa me nga një kopje të propozimit është njoftuar debitori i cili në afatin e paraparë ligjorë ka paraqitur Prapësim.

Përmbaruesi privat më datë 12.03.2021, e ka nxjerr urdhërin P.nr.124/2021, dhe një kopje të propozimit të lejuar për përmbaram me prova i'a ka dërguar debitorit, i cili më datë 22.03.2021, e ka pranuar propozimin së bashku me prova.

Debitori më datë 24.03.2021, ndaj urdhërit përmbarues ka paraqitur prapësim me të cilin i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhri P.nr.124/2021 të datës 12.03.2021, sepse propozimi për përmbaram është i bazuar për arsye sepse urdhëri për përmbaram nga përmbaruesi është i pa rregullt ngase i njëjti bazohet në një shkresë që kreditori në marrëveshje të një anshme e pa verifikuar se cilit person i është dorëzuar. Po ashtu ka potencuar se nuk ka marrë kurrfarë shërbimi nga kreditori, fatura është tërësisht e pa papranueshme, jo e rregullt dhe jo ligjore.

Përmbaruesi me datën 29.03.2021, e ka njoftuar kreditorin për të drejtën për parqitjen e përgjigjës në prapësim. Kreditori me datën 02.04.2021, ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën i ka propozuar gjykatës që prapësimi të refuzohet si i pa bazuar sepse i njëjti nuk është i bazura në prova të duhura dhe ato prova nuk i'a bashkangjitur prapësimi ashtu siq është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së.

Po ashtu ka thekësuar se propozimi për përbarim është i bazuar në bazë të dokumentit të besueshëm –faturës e cila i përmbajnë të gjitha elementet e parapar me ligjë, ashtu siqë është parapar me neni 29 të LPP-së, ndër të tjera theksojmë se procedura është iniciuar konform Kontratës së Kredisë të cilën debitorët e kanë nënshkruar me kreditorin, në të cilën parashihet procedurat që do të ndërmerren në rast të mosë pagesës së Kredisë, dhe i njëjti është pajtuar dhe ka qen i njoftuar për kthimin e Kredisë dhe të drejtat e tij mbi pengun të përcaktuar me Ligjin Nr.03/L-154 Për Pronësinë dhe Të Drejtat Tjera pronësore., po ashtu pretendimet e debitorit që i njëjti ka kryer pagesat e kësteve konform skemës së pagesave , nuk qëndrojnë pasi i njëjti nuk ka respektuar marrëveshjet me kreditorin duke mosë paguar dhe as shumën e tyre sikurse në marrëveshje, po ashtu ka theksuar se ka qen koha e pandemisë dhe gjatë asaj kohë e ka pas nënën të sëmurë dhe nuk ka mundur të kryej detyrimet tona.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vendosi që të refuzojë prapësimin e debitorit, në tërësi si të pa bazuar, sepse debitori bazën për prapësim nuk e ka mbështetur me prova të duhura dhe ato prova nuk i'a bashkangjitur prapësimin ashtu siq është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së.

Po ashtu nuk ekzistojnë asnjë nga shkaqet e parapara në bazë të nenit 71 nga pika (1.1) deri tek pika (1.12) të LPP-së, prandaj gjykata nga arsyet e cekura më lart vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata i analizoi në tërësi pretendimet e Debitorit, mirëpo të njëjtave nuk ua fali besimin për këto arsye: Dokumenti përbarimor-fatura të cilat gjinden në shkresat e lëndës janë titull ekzekutiv dhe i ka të gjitha tiparet e përbarueshmërisë , ashtu siq është paraparë me nenin 29 të LPP-së, (neni 29 pika 3 -Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar).

Dokumenti përbarimor nga ana e Kreditorit i është dorëzuar në mënyrë të rregullt debitorit, ky fakt vërtetohet nga marrëveshja e kontratës mbi kredinë, të cilat janë nënshkruar nga Debitori.

Gjykata i analizoi në tërësi edhe pretendimet Kreditori të paraqitura në propozimin për përmbarim dhe në përgjigje në prapësim dhe të njëjtave ua falë besimin për shkak se ishin të drejta dhe të ligjshme për të gjitha arsyet e cekura më lartë.

Gjykata e detyroi debitorin që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore të cilat do të llogariten nga përmbaruesi privat, bazuar në nenin 13 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

PPP.nr.21/2021 datë 12.11.2024

Gjyqtari,
Burhan Berisha

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.